



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:916354

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06216496

C.nr.529/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA E GJYKATËS NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil duke vendosur si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Raif Fazliu, në çështjen kontestimore të paditësit F.Snga R., Komuna e Vitisë, të cilin me autorizim e përfaqëson L.E. avokat në Viti, kundër të paditurës Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a.(KEDS), Bulevardi “Bill Klinton” nr.3, Ndërtesa e Elektrokosovës kati II.nr. 5, Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim D.D.-jurist pranë Zyrës Ligjore rajonale të kompanisë në Gjilan, me bazën juridike kompensimit i dëmit material, vlera e kontestit 3,334.73 euro, pas mbajtjes së seancës kryesore në prani të përfaqësuesve të palëve, me 19.09.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET në tërsi e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.S. nga R., Komuna e Vitisë, **DETYROHET** e paditura Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.a.(KEDS), me seli në Prishtinë që në emër të kompensimit-shpërblimit të dëmit material, si pasojë e këputjes së telit të tensionit të lartë, në arën - ngastrën e paditësit, me ç`rast iu ishte kalbur perimkultura e lakrës në sasi prej 21,667 kg. t`ia kompensojë dëmin në shumën prej **3,334.73 €**, duke e llogaritur me kamatë ligjore prej 8 %, nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë (me datë 08.01.2015), deri në pagesën përfundimtare, nën pasojën e përmbarrimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura KEDS që paditësit F.S., t`ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe ate: 50 euro për pagimin e taksës në padi, 810 € për përfaqësim të avokatit në 6 seanca gjyqësore secilën nga 135 euro dhe 150 € euro për shpërblimin e ekspertizës së ekspertit të bujqësisë, apo gjithësej **1,010 €** euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën pasojën e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditesi F.Snga R. i Vitisë, përmes padisë dhe kërkesëpadisë të dorëzuar në gjykatë me date 08.01.2015, kishte theksuar se në arën në pronësi faktike të tij me 32 ari, kishte të mbjell 8,500 koka të perimkulturës lakër, e që shprehur në kg.diku 34,000 kg. Nëpër arën e tij kalon tensioni i lartë i energjisë elektrike, kurse në muajin Nëntor 2014, ishte këputur një tel nga ky tension, kishte rënë në arë mbi lakrat e tija, ku nga frika e rrymës elektrike ky nuk ka patur guxim të hyj në arë dhe ti vjeli lakrat. Paditësi i kishte njoftuar zyrtarët e të paditurës KEDS, për ta ngritur dhe lidhur telin, por zyrtarët e të paditurës nuk kishin ardhur për tri javë ditë, kështu që më pastaj kishte ndodhur vërshimi i shtratit të lumit “Morava”, ndërsa ara me lakra ishte afër lumit, andaj edhe ato janë mbushur me rërë dhe lym dhe si pasojë edhe janë prishur tërësisht

lakrat. Kishte kërkuar kompensim nga e paditura, por kishte refuzuar, andaj në kërkesëpadi ka kërkuar shumën prej 8,500 €.

E paditura KEDS, përmes përgjigjes në padi e kishte kontestuar kërkesëpadinë e paditësit, si për nga baza, ashtu edhe për nga lartësia, për arsye se lakrat nuk janë dëmtuar nga tensioni i rrymes elektrike, por nga vërshimet siç pohon edhe vetë paditësi, andaj fajtor nuk mund të jetë e paditura, duke u thirr në nenin 158, të LMD-së, lirimi nga përgjegjësia. E paditura ka bërë fajtores paditësin me faktin se ai ka qenë dashur ta siguroj dhe nxjerr provën përmes gjykatës neni 379, i LPK-së.

Paditësi F.S., përmes përfaqësuesit të tij av. L.E., në seancën përgatitore me 24.05.2018, kishte mbetur në terësi pranë padisë dhe kërkesëpadiës, duke kërkuar nga Gjykata që ta detyrojë të paditurën KEDS, që t'ia kompensojë dëmin material paditësit, pra me një fjalë përsëritur përmbajtjen e padisë. Kishte propozuar caktimin e një eksperti të bujqësisë, në rast se e paditura nuk e kompenzon dëmin si në kërkesëpadi.

Përfaqësuesja e të paditurës KEDS, Sadete Murati, në terësi e kishte kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, në mungesë të argumentimit të saj me prova materiale, duke shtuar se vetë paditësi e pranon se lakrat iu ishin prishur si rezultat i vërshimeve të ndodhura, andaj ishte thirrur në nenin 158 të LMD-së. Si kompani sa herë që informohemi për ndonjë prishje apo avari, intervenojmë në terren dhe nuk ka mundesi aq gjatë të qendroj teli i këputur në arën e paditësit, po të ishim informuar nga ai apo dikush tjetër. Kishte kundërshtuar nxjerrjen e ekspertizës, pasi që ka kaluar kohë e gjatë dhe nuk është e mundur që paditësi në sipërfaqen prej 32 ari të mos guxoj t'i nxjerr lakrat nga ara.

Përfaqësuesi i paditësit e kishte kundërshtuar përfaqësuesen e të paditurës, duke i thënë se KEDS, ishte i njoftuar për këtë defekt dhe paditësi me kohë ishte drejtuar për kompensimin e dëmit, por e paditura nuk ishte përgjigjur fare. Kishte propozuar që në cilësi të dëshmitarëve të dëgjohen A.Z. nga R., I.R., operator në terren pranë të paditurës dhe vetë pala paditëse F.S..

E paditura kishte propozuar të dëgjohen si dëshmitarë I.R. dhe S.S.. Gjykata kishte refuzuar nxjerrjen e ekspertizës se ekspertit të bujqësisë si të parakohshme, ndërsa i kishte pranuar propozimet e ndërëgjyqësve për dëgjimin e dëshmitarëve.

Në seancën e radhës me 20.06.2018, përfaqësuesi i paditësit av. L.E., kishte mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadiës, duke potencuar se dëmi i shkaktuar në kulturën e lakrës ishte qind për qind aq sa kishte të mbjellura.

- **F.** Në cilësinë e palës paditëse mes tjerash kishte thënë se pasi ishte këputur teli dhe kishte rënë në arën e tij e kishte informuar KEDS-in, njësinë në Viti përmes telefonit, pastaj kishte shku personalisht në zyrën në Viti, pastaj te trafostacioni në S.S., e më pas edhe në Stacionin Policor në P.. Pasi ishin lajmëru nga Policia e Kosovës, pas dy dite kishte ardhur një veturë e Keds-it, në të cilën ishin I.R. dhe një person tjetër, kishin fotografuar lakrat, ku pas tri dite ishin ardhur ekipa dhe e kishin menjanuar defektin, kur edhe unë pastaj kam shkuar te lakrat në arën time.

Teli ishte këputur në formë diagonale ku ishin lakrat dhe ishte e pamundur t'i nxjerr lakrat nga rreziku prej teli dhe nga lagështia në arë që ishte.

Në pyetjen e avokatit të tij, se a kishte provu paditësi t'i nxjerr lakrat para se me u menjanu defekti, ai ishte përgjigjur po, por nuk kam patur guxim, nga se në një situatë të njëjtë në fshatin tonë, nga rryma kishte pësuar një lopë, por edhe njerëzit ishin goditur. Për ndryshe lakrat i kisha të shitura dhe të porositura nga blerësit e ndryshëm, kurse teli kishte qëndruar perafërsisht 15 ditë në arë.

Ndërsa, përfaqësuesit të paditurit D.D., paditësi iu ishte përgjigjur se teli ishte këputur afërsisht me 10. Nëntor 2014, ndërsa e kam lajmëru qendrën e thirrjeve, e cila me kishte udhëzuar të shkoj në zyrën e KEDS-it në S.S..

- Edhe dëshmitari tjetër **A.Z.** kishte thenë se preferon të shetis rreth lumenjve, ku kishte vrejtur telin e këputur, në arën me lakra te F.S.t, ku nga pasioni për të ecur persëri pas 3-4 ditësh kishte vrejtur telin në vendin e njëjtë të këputur, por prap edhe pas një jave e kisha vërejtur po ashtu.

- Dëshmitari S.S., punëtor i Keds-it, kishte thënë se në rastin konkret ai tel nuk ka pasur rrezik, pasi që nuk ka pasur rrymë, sepse po të kishte rrymë me rastin e kontaktit të telit me tokën do të binte, ndërsa nënstationi në S.S., ose Ramnishtë do të binin nga sistemi. Kishte pranuar se nga I.R. ishte informuar se një tel në arën e F.S.t ishte këputur dhe kishte rënë në tokë, po ishte përgjigjur dëshmitari dhe e kishte informuar I.n se ky përques nuk e përçon rrymën, duke shtuar se rasti paska ndodhur në muajin Nëntor, kurse I. e kishte lajmëruar në dhjetor 2014, së paku tri javë me vonë, duke dhënë më pas mendimin profesional se edhe ai e kishte vërejtur telin e këputur dhe lakrat gjysëm të fundosura, por nuk ishte rrezikuar nga rryma, ndërsa kishte pranuar se po të isha edhe unë në vendin e F.t, natyrisht se nuk do të guxoja të futesha në arë për të vjelë lakrat, por do të insistoja që më urgjent të eliminohet defekti.

Pas kësaj situatë me propozimin e palës paditëse gjykata kishte lejuar nxjerrjen e ekspertizës së ekspertit të lëmisë së bujqësisë, si dhe për dëgjimin e dëshmitarit I.R..

Në vendin e ngjarjes me 12.07.2018, gjykata kishte konstatuar se ngastra ku kishin qenë të mbjellura lakrat ishte në pronësi faktike të F.S., ndërsa pronar juridik ishte Joviq Stanoje (Vasiljka), pra ngastra nr.799-0, me 3064 m², në ZK R.. Këtë ngastër tërthorazi e prenin largpërçuesit 35 KW, në relacionin S.S.-Lladovë-Gjilan, pra largpërçuesit në formë diagonale qëndronin mbi ngastrën nr.799-0.

- Eksperti gjyqësor ing.i diplomuar i bujqësisë S.A. kishte llogaritur se sipërfaqja e mbjell me kulturën e lakrës prej 3064 m², nga ngastra nr.799-0, ZK R., në kushte normale do të jepte rendiment prej 21,667 kg, ndërsa duke llogaritur shpenzimet ajo do të shitej nga 0.19 €, për kg. e që në total në rast se do të shiteshin do të shiteshin për 3,334.73 euro. Ky përfundim ishte nxjerr nga të dhënat shkencore profesionale dhe krahasuese, i cili kishte nxjerr çmimin e një kg.lakre në vitin 2014, nga tre kultivues të kësaj perimkulture.

Ndërkohë, pala e paditur përmes parashtresës së datës 25.09.2018, e kishte kundërshtuar ekspertizën, duke e konsideruar të pa bazuar në fakte dhe të vonuar.

Gjykata seancën e fundit të shqyrtimit kryesor e kishte caktuar dhe mbajtur me 29.10.2018, në të cilën kishte prezentuar hartuesi i ekspertizës nga lëmi i bujqësisë ing. i diplomuar i bujqësisë Skender Ahmeti, duke mbetur tërësisht sikur në mendimin e paraqitur në formën e shkruar, duke ju përgjigjur edhe pyetjeve nga palët ndërgjyqëse.

- Dëshmitari **I.R.**, i cili kishte deklaruar se teli i këputur si në rastin konkret shërben për mbrojtje të telave tjerë nga goditja e rrufesë dhe nuk përçon rrymë. Nuk iu kujtohej se a ishte në vendin e ngjarjes apo jo, kur ishte lajmëruar nga paditësi, për këputjen e telit.

Gjykata përmes Aktgjykimit C.nr.8/2015, të datës 29.10.2018 e kishte miratuar sit ë bazuar kërkesëpadinë e paditësi, por pas ankesës së ushtruar nga ana e të paditurës, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit Ac.nr.555/19, të datës 20.10.2023, e kishte miratuar si të bazuar ankesën, duke e prish Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa lëndën e kishte kthyer në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me date 26.04.2024, përfaqësuesi i paditësit avokati L.E., ishte deklaruar se mbetet tërësisht pranë kërkesëpadisë dhe shqyrtimeve si në seancat e mbajtura më herët, ndërsa duke u arsyetuar në pak vërejtjet e gjykatës së Apelit në raport me vendimin e vendosjes në herën e parë ka thënë se dëmi material në perimkulturën e lakrës ka ndodhur si pasojë e këputjes së telit të përquesit elektrik, për të cilin defekt me kohë ishte lajmëruar e paditura KEDS, të cilin fakt e ka pranuar edhe I.R. operator i Keds-it në terren, duke e kritikuar dëshminë e tij të dhënë në gjykatë, i cili kishte thënë se nuk më kujtohet, kur e dine mirë se së pari paditësi kishte lajmëruar Stacionin Policor në P., pastaj Keds-in, por nuk

kishin ardh me kohë ta rregullojnë telin, andaj nga neglizhenca e Keds-it ka sjell deri te mosguximi i vjeljes së lakrave, ku më pas nga dalja e rrjedhës së shtratit të lumit, lakrat janë kalbur dhe mbushur me lym e rërë, duke shtuar se kabloja ishte pengesë për mosvjeljen e lakrave nga nga ara paditësi, ndërsa vërshimi i ujit kishte ndodhur 10 ditë më vonë, pas këputjes së telit, ndërsa paditësi nuk e ka vënë në sprovë vehten dhe familjen e tij, pasi që në fshat kishin ndodhur ngjarje të rënda pikërisht si pasojë e këputjes së telave të rrymës.

Lidhur me dilemën e legjitimitetit aktiv të paditësit, ky përfaqësues ka thënë se arën e njëjtë paditësi e ka pasur dhe vazhdon ta ketë në posedim të vazhdueshëm edhe tani, për të cilën dilemë sipas jush e dine i tërë fshati, duke njoftuar se vitin e kaluar në ngastrën-arën e njëjtë paditësi ka hapur pusin apo siç thuhet në popull bunarin, ku për sqarimin e këtyre rrethanave ka propozuar që në cilësi të dëshmitarëve të dëgjohej F.D., i cili në kohën e shkaktimit të demit ishte administrator i fshatit dhe A.Z., si dhe propozimin për përsëritjen e ekspertizës së bujqësisë.

Përfaqësuesi i të paditurës Keds D.D., e ka kontestuar kërkesëpadinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia, duke mbetur pranë përgjigjes në padi, duke pretenduar se e paditura nuk mbanë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga vërshimet, e jo si rezultat i telit të energjisë elektrike. Ka propozuar që gjykata të verifikoj faktin se paditësi a mos rastësisht për këtë dëm është kompensuar nga Komuna e Vitisë, apo edhe nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), ndërsa për të vërtetuar se teli i këputur rrymë, nuk ka patur rrymë ka propozuar që të nxjerret ekspert të elektrikës.

Gjykata i ka pranuar si të bazuara gjitha propozimet e palës së paditur, si për caktimin e ekspertit të elektrikës, ashtu edhe për sigurimin provave nga MBPZHR dhe nga Komuna e Vitisë, si dhe për dëgjimin e dëshmitarëve, por ka refuzuar propozimin për përsëritjen e nxjerrjes së ekspertizës së bujqësisë

Për ekspert të elektrikës gjykata ka caktuar ekspertin I.C., i cili ka sqaruar rolin e telit apo përçuesit mbrojtës i cili vendoset në maje të shtyllave i cili ka për detyrë ti mbroj përçuesit e linjës nga rufeja elektrike. Në rastin konkret ky përçues mbrojtës paraqet rrezik permanent të ngarkohet me energji elektrike në dy rastet e mundshme. Rastim më të thjesht e ka sqaruar duke thënë se “në qoftë se personat e pa autorizuar nga KEDS-i, do të kishin tentuar ta lokalizonin përçuesin pa e ndërprerë tensionin elektrik, në atë linjë do të ndodhte aksident me fatalitet, lidhje e shkurtë njëfazore me tokë përmes trupit të njeriut, duke e konsideruar zonën ku ka qëndruar përçuesi elektrik si zonë të minuar”.

Eksperti elektrikës atë që e kishte shkruar në ekspertizë, e kishte mbrojtur edhe në seancën gjyqësore të datës 30.08.2024, duke mbetur në tërësi pranë saj, i cili ju ishte përgjigjur pales paditëse për “fushën e minuar”, duke sqaruar se “*kush do ta kishte fatin apo fatkeqësinë që mbi këtë përçues apo tel të shkelte mbi të deri sa ai të qëndronte në tokë, apo në afërsi deri në 10 metra në dy anët e telit, ndërsa në atë rast po që se do të kishte shkarkime atmosferike, ai person do ta gjente fatalitetin, pasi nuk do të mund ti shmangej vdekjes*”.

Eksperti iu ishte përgjigjur edhe pyetjeve të përfaqësuesit të paditurës, por që fare nuk ndryshoi mendjen ta korrigjojë në asnjë rast, përmbajtjen e ekspertizës së shkruar, madje në mënyrë profesionale ka sqaruar çdo detaj të ekspertizës.

Pala e paditur pasi ka kundërshtuar mendimin e ekspertit të elektrikës, propozoi që gjykata ta lejoj nxjerrjen e një ekspertize tjetër nga lëmi i elektrikës, por gjykata e refuzoi një propozim të tillë, me arsyetimin se pasoja nuk ishte si rrjedhojë e drejtpërdrejt nga energjia elektrike, por nga rreziku potencial ka rrjedh pasoja.

Gjykata ka dëgjuar dëshmitarët si **Y.H.** i cili ka thënë se në arën e F.S.t diku para 10 viteve e kishte vërejtur telin e këputur në arën e tij të mbjell me lakra, e nga rreziku F. nuk kishte

guxuar ti vjeli lakrat, pasi se nuk ishte hera e parë që për shkak shtyllave të dobëta të këputen telat e energjisë.

Ky dëshmitar ju ishte përgjigjur gjykatës se ara që e mbjell F. nuk e di e kujt është, por prej se mbaj mend kishte thënë se këtë arë e punon dhe e mbjell F.S..Njëjtë kishte dëshmuar edhe dëshmitari E.F., për ekzistimit të telit të këputur.

Në seancën kryesore me datë 19.09.2024, gjykata nga provat kishte lexuar; kërkesën për dëmshpërblim të datës 04.12.2014, e paditësit F.S., të drejtuar Keds-it, raportin e Komunës së Vitisë drejtuar Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural , Certifikatën e pronës për ngastren nr.799-0, ZK R., e dates 09.07.2018, në emër të Joviq Stanoje, një dokument emaili të datës 09.12.2014, i dërguar nga I.R., për S.S., vlerësimi-ekspertiza e ekspertit të bujqësisë Skender Ahmeti, e datës 25.07.2018, Ekspertiza e ekspertit të elektrikës I.C., Përgjigjen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e datës 09.07.2024, si dhe përgjigja nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit e Komunës së Vitisë e datës 24.07.2024.

Në fjalën përfundimtare të përfaqësuesit të paditësit F.S., av. L.E. ka thënë se mbetet pranë padisë, kërkesëpadisë dhe deklarimeve sin ë shqyrtimet gjyqësore, të cilat pretendime i vërtetuan edhe ekspertizat e nxjerra në këtë çështje konkrete, ndërsa kishte kërkuar shpërblimin për dëmin e shkaktuar nga e paditura ashtu siç ka vlerësuar eksperti i bujqësisë prej 3,334.73 €, me kamatë vjetore prej 8%, nga paraqitja e padisë në gjykatë, deri në pagesën definitive. Gjithashtu kishte kërkuar shpenzimet e procedurës duke i specifikuar një nga një, si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimi.

Përfaqësuesi i të paditurës, KEDS, D.D. në fjalën fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar kërkesëpadinë, nga se kishte përsëritur se nuk janë fajtor e paditura, por vërshimet nga shiu i lumit “Morava” i cili kishte dalur nga shtrati dhe kishte dëmtuar edhe lakrat e paditësit. Prandaj paditësi në një mënyrë kishte kërkuar të kompensohet nga Komuna e Vitisë, ndersa në anën tjetër ishte munduar të gjej arsye, kinse nuk ka mundur t`i marr lakrat nga ara per shkak të telit të këputur, prandaj kishte propozuar refuzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 8, të LPK-së, vlerësoi provat veç e veç dhe si tërësi, andaj konstaton se:

- Me leximin e kërkesës për dëmshpërblim të datës 04.12.2014, nga ana e paditësit F.S., të drejtuar Keds-it, gjykata vërteton se paditësi iu ishte drejtuar me kohë të paditurës nga e cila kishte kërkuar kompensimin per shkak se nuk kishte mundur t`i tërheq lakrat nga ara e tij, nga rreziku se mund të pësonte ai dhe ndonjë anëtar tjetër i familjes së tij, apo kushdo që provon të futet në arë.

- Me leximin e Raportit të Komunës së Vitisë drejtuar Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjykata mëson se Komuna e Vitisë iu ishte drejtuar MBPZHR-së, duke e informuar se këtij bujku i ishte shkaktuar dëm nga vërshimet në arën e tij. Kjo ishte kërkesë dhe raport i vetëm, ndërsa vërshimet ishin për gjithë bujqit, por të tjerët nuk ishin të rrezikuar nga teli që kishte rënë vetëm në arën e paditësit.Pra raporti ishte individual, e jo kolektiv.

-Nga certifikata e pronës për ngastren nr.799-0, ZK R., e datës 09.07.2018, në emër të Joviq Stanoje, mësohet se ara ishte dhe ende është e regjistruar në emër të pronarit juridik Joviq Stanoje, por që ishte në posedim dhe shfrytëzim të paditësit. Ky fakt asnjëherë nuk ishte kontestues.

- Me leximin e një dokumenti - emaili i datës 09.12.2014, i derguar nga I.R., për S.S., gjykata mëson dhe vërteton se Izet Sylejmani pasi ishte informuar nga paditësi F.Spër telin e këputur, e kishte informuar menaxherin, respektivisht ekspertin për siguri dhe mbrojtjen e pasurisë dhe

personave në KEDS, S.S.n, për telin e këputur me një vonesë të konsiderueshme. Po të mos lajmëronte paditësi dhe po të mos ishte në vendin e ngjarjes I. pas rënies së telit, e pa besueshme do të ishte të dinte I. se në cilën arë ka rënë teli.

- Ekspertiza e ekspertit të bujqësisë Skender Ahmeti, e dates 25.07.2018 dhe sqarimi i saj në seancën gjyqësore të datës 29.10.2018, përcaktojnë lartësinë e kompensimit të demit të shkaktuar.

- Se vërtetë teli i këputur paraqiste rrezik permanent me gjendje të tillë, e vërteton Ekspertiza e ekspertit të elektrikës I.C., i cili duke sqaruar mendimin e tij dhe duke ju përgjigjur palës paditëse për “fushën e minuar”, siç e quante ai fushën ku kishte rënë teli, ka sqaruar se *“kush do ta kishte fatin apo fatkeqësinë që mbi këtë përçues apo tel të shkelte mbi të deri sa ai të qëndronte në tokë, apo në afërsi deri në 10 metra në dy anët e telit, ndërsa në atë rast nëse do të kishte shkarkime atmosferike, ai person do ta gjente fatalitetin, pasi nuk do të mund ti shmangej vdekjes”*. Përçuesi mbrojtës ka paraqitur rrezik permanent po që se do të ngarkohej. Po që se do të kishin tentuar ta lokalizonin përçuesin pa e ndërprerë tensionin elektrik, në atë linjë do të ndodhte aksident me fatalitet, lidhje e shkurtë njëfazore me tokë përmes trupit të njeriut, duke e konsideruar zonën ku ka qëndruar përçuesi elektrik si zonë të minuar.

- Ndërsa dy provat e fundit si Përgjigja e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e datës 09.07.2024, si dhe përgjigja nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit e Komunës së Vitisë e datës 24.07.2024, dëshmojnë se paditësi F.Sbazar në Raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore gjatë vitit 2014, nuk ishte kompensuar për çfarëdo demi material të shkaktuar nga vërshimet e shiut me datën 18 dhe 19 Nëntor 2014.

Barrën kryesore për vërtetimin e shkakimit të demit dhe datës së shkakimit të demit, e paraqet Raporti i Komunës së Vitisë drejtuar Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa arsyetimin e mosveprimit të paditësit për mos largim të telit-kabllos së këputur, e paraqet ekspertiza e ekspertit të elektrikës I.C.

Edhe dëshmitë e dëshmitarëve si të, A.Z.i cili kishte thënë se kishte vërejtur telin e këputur, në arën me lakra të F.S.t, ku edhe pas një jave e kishte vërejtur në arën e F.t, pastaj dëshmia e S.S., punëtor i Keds-it, i cili edhe pse kishte thënë se në rastin konkret ai tel nuk ka paraqitur rrezik, pasi që nuk ka pasur rrymë, pastaj nga I.R. ishte informuar se një tel në arën e F.S.t ishte këputur dhe kishte rënë në tokë, pastaj se I. e kishte lajmëruar në dhjetor 2014, me vonesë të theksuar, ndërsa duke shtuar se po të isha edhe unë në vendin e F.S.t, natyrisht se nuk do të guxoja të futesha në arë për t'i nxjerrur lakrat, por do të insistoja që më urgjent të eliminohet defekti, flasin mjaft në llogari të kërkesës së paditësit, i cili i priste t'i vjelte lakrat. Pra, neglizhenca e të paditurës kishte për pasojë vonesën e sanimit të defektit, njëherit edhe mos guximit të paditësit të futet në arën e tij. Mos futjen në arë për ti vjel lakrat e ka arsyetuar hollsisht edhe eksperti i elektrikës, duke pohuar se mosveprimi i paditësit ka zgjedh pasojën më të vogël në rastin konkret.

- Si tërësi këto prova vërtetojnë përgjegjësinë objektive të paditurës, nga e cila buron e drejta subjektive e paditësit.

- Vlen të theksohet se edhe pse nuk ishte kontestues legjitimiteti i paditësit si palë aktive, gjykata është kujdesur që përmes dëshmitarëve ta vërtetoj se paditësi arën e mbjell me lakër e punon vazhdimisht hiq më pak se para mbi 30 viteve, të cilin fakt e kishin pohuar dëshmitarët Y.H.dhe E.F., ndërsa pala padiëse këtë pretendim e kishte forcuar edhe me njoftimin e tij, se

vitin akaluar ka hap pus-bunar mu në ngastrën e mbjell me lakër edhe pse nuk është e domosdoshme që në rastin konkret të vërtetohet legjitimiteti i palës aktive, sa është vërtetimi i shkaktimit të demit dhe me fajin e kujt demi është shkaktuar.

Se ishte këputur teli shumë ditë para se të ndodhin vërshimet në atë zonë, e vërteton deklarata e përfaqësuesit të paditësit në shqyrtimet e kësaj çështje e përsëritur edhe në fjalën përfundimtare.

Gjykata konsideron se vërtetimi i fakteve vendimtare përmes provave në shkresat e lëndës siç janë vërtetimi i legjitimitetit të palës aktive, raportimi i këputjes së kabllos tek e paditura por edhe tek organet tjera kompetente, siç janë Policia e Kosovës, para se të ndodhin vërshimet në zonën ku ndodhet ara e paditësit, mjaftueshëm e vërtetojnë lidhjen kauzale shkak – pasojë, si rezultat i këtij vërtetimi buron edhe e drejta subjektive e paditësit ndaj të paditurës për kompensimin e demit të shkaktuar.

Në anën tjetër deklaratat e ofruara nga pala e paditur, nuk paraqesin bazë për shmangien e përgjegjësisë. Prandaj gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse. Pretendimi i palës së paditur se lakrat nuk iu janë dëmtuar nga tensioni i rrymës elektrike, por nga vërshimet, andaj fajtor nuk mund të jetë e paditura, duke u thirrur në nenin 158, të LMD-së (lirimi nga përgjegjësia), nuk mund ta pranoj gjykata, sepse dëmi nuk shkaktohet gjithnjë drejtpërdrejt, ai mund të shkaktohet edhe indirekt, sikur edhe me mosveprim, si në rastin konkret.

E paditura ka bërë fajtor paditësin sepse ai ka qenë dashur ta siguroj dhe nxjerri paraprovën përmes gjykatës neni 379, i LPK-së, nuk është gjithnjë ashtu, sepse paditësi nuk ka pritur se do ti vërshohet ara nga uji, trk ai ka ekzistuar priti legjitime, se dëmi do t'i kompensohet në procedurë jashtëgjyqësore.

Në rastin konkret dëmi është shkaktuar me veprimin pasiv, nga se e paditura nuk kishte ndërmarr masat adekuate për largimin e telit nga ara e paditësit, andaj edhe pse e paditura nuk ka faj, mbanë përgjegjësi objektive, sepse kablloja elektrike paraqet sendin e rrezikshëm. Gjithashtu, edhe lidhja kauzale e mosveprimit e të paditurës me sendin e rrezikshëm dhe demit të shkaktuar ekziston, pra në esencë ekziston lidhja kauzale ndërmjet shkakut dhe pasojës, prandaj kemi edhe përgjegjësinë civile, si përgjegjësi objektive për të paditurën.

Gjykata duke u bazuar në gjitha këto prova dhe fakte të pakontestueshme, duke qenë e pavarur në vendosje, miratoi kërkesëpadinë e paditësit, si në dispozitiv të vendimit, duke e bazuar në prezumimin e kauzalitetit neni 154 dhe 155 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Ligji nr.04/L-077, pasi që pronar i sendit të rrezikshëm dhe veprimtarisë së rrezikshme ka qenë dashur të kryhet nga e paditura.

Me dispozitën e nenit 154 i cili sqaron Prezumimin e kauzalitetit thuhet citojmë: ‘Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari, përveç nëse provohet se ato nuk kanë qenë shkak i demit, ndërsa në nenin 155 të po të njëjtit ligj citojmë: Për dëmin nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi-pronari i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me të.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se; kush i shkakton dëm tjetrit, ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se demi është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa në paragrafin 2 të këtij neni thuhet, Për dëmin nga sendet ose veprimtaritë, nga të cilat rrjedh rreziku i shtuar i demit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji.

Në rastin konkret nuk ka dilemma se është vërtetuar lidhja kauzale shkak – pasojë, pasi paditësi me kohë e kishte lamëruar të paditurën për rrezikun që mund ti ndodhë nga këputja e telit në arën e tij, madje edhe përmes Policisë së Kosovës, por e paditura e kishte neglizhuar intervenimin për sanimin e defektit, të cilin pohim e ka përsëritur shumë here vetë paditësi, e që e kishte pranuar edhe operatori në Keds I.R..

Duke u nisur nga kjo gjendje dhe nga provat materiale që ka ofruar pala paditëse, gjykata duke vërtetuar drejt dhe saktë gjendjen faktike, konstaton se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e bazuar në prova e fakte.

Vendimi lidhur me kamatëvonesën prej 8% u bazua në nenin 382 të LMD-së, derisa për shpenzimet e procedurës kontestimore në nenin 452.1 të LPK-së. Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË VITI
C.nr. 529/2024
Më:19.09.2024

G j y q t a r i
Raif Fazliu

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimi të njejtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.